

Në bazë të nenit 25 dhe 47 paragrafi 1 pika 20 nga Ligji i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158/10, 123/12, 43/14, 153/15 dhe 6/16), Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë miratoi

VENDIM PËR LËSHIM NË QARKULLIM TË KARTËMONEDHAVE ME VLERË NOMINALE 100 DENARË

1. Me këtë vendim lëshohen në qarkullim kartëmonedhat me vlerë nominale 100 denarë me shenjë të shtypjes "MAJ 2018" dhe me karakteristikat e parapara në Vendimin për emetim, vlerë nominale dhe karakteristika themelore të kartëmonedhave ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 45/96), Vendimin për emetimin e kartëmonedhave me vlerë nominale 100 denarë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 16/00) dhe Vendimin për emetimin e kartëmonedhave me vlerë nominale 10, 50 dhe 100 denarë, me karakteristika të ndryshuara ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 04/01), duke filluar nga data 2 maj i vitit 2018.

2. Me lëshimin në qarkullim të kartëmonedhave nga pika 1 e këtij vendimi, paralelisht në qarkullim në operacionet me para të gatshme në Republikën e Maqedonisë do të jenë edhe kartëmonedhat me vlerë nominale 100 denarë, të emetuara në bazë të Vendimit për emetim, vlerë nominale dhe karakteristika themelore të kartëmonedhave ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 45/96), Vendimin për emetimin e kartëmonedhave me vlerë nominale 100 denarë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 16/00), Vendimin për emetimin e kartëmonedhave me vlerë nominale 10, 50 dhe 100 denarë, me karakteristika të ndryshuara ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 04/01) dhe Vendimit për emetimin e kartëmonedhave me vlerë nominale 100, 500 dhe 1000 denarë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 139/08).

3. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e shpalljes në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

Nr.V. 02-15/VI-6/2018
29 mars viti 2018
Shkup

Guvernator dhe Kryetar
i Këshillit të Bankës Popullore
të Republikës së Maqedonisë
Dimitar Bogov